

*Fjala e hapjes së Konferencës Shkencore*  
*Justina Shiroka PULA, Anëtare Korrespondente*  
*Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore (SSHSH)*  
*Prishtinë, 17.05.2018*

## **PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT**

Të nderuar Akademikë, zonja dhe zotërinj e mysafirë të nderuar

Kam nderin që, në emër të Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të mbaj fjalën hyrëse në hapjen e punimeve të Simpoziumit shkencor ndërkombëtar “PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT”.

Ky simpozium, në vitin e dhjetë të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, është planifikuar nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe është mbështetur edhe nga seksionet e tjera dhe nga organet vendimmarrëse të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Është vlerësuar se tema “PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT” paraqet një temë shumë aktuale dhe të rëndësishme dhe një kontribut të rëndësishëm për të ardhmen e vendit.

Në përvjetorin e 10-të të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, nuk do ta harrojmë dhe nuk do ta lëmë pa e përkujtuar edhe të kaluarën, *e cila është një dimension tjetër i jetës sonë të lavdishme*, orientimin properëndimor të rezistencës civile dhe përkushtimin e rezistencës së armatosur në Kosovë, të cilat shënuan një kthesë historike për ta arritur mbështetjen e duhur politike, dhe që në fakt janë kontribuues në krijimin e shtetit të Kosovës.

Deri në shpalljen e Pavarësisë, më 17.02.2018, Kosova ishte e administruar nga Kombet e Bashkuara. Tani jemi shtet i pavarur, sovran dhe i njohur nga shumica e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Natyrisht, në këtë dhjetëvjetor të pavarësisë, s’ka se si të mos e kujtojmë kontributin e miqve të mëdhenj të Kosovës, kongresistëve dhe diplomatëve amerikanë, si dhe të të gjitha vendet e tjera aleate, për rolin dhe përkushtimin e tyre aktiv për Kosovën shtet të pavarur.

Mirëpo, tani do ta shikojmë të tashmen dhe të ardhmen. Këto dy dimensione duhen të jenë synim për të pasur një të ardhme të ndritshme dhe perspektive, e cila mund të arrihet me politikë aktive vendore *dhe në bashkëpunim me të gjithë ata që ndihmuan në krijimin e shtetit tonë*.

*Të nderuar pjesëmarrës,*

Siç edhe mund ta vërejmë nga pjesëmarrësit në këtë simpozium, intelektualë e diplomatë, ekspertë të fushave të ndryshme, që ndërliiden me temën e shtruar për trajtim në simpozium, është e qartë se tema PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT ngjall gjithmonë interes dhe është një temë në të cilën ka çka të trajtohet e çka të thuhet.

Në punimet e këtij simpoziumi do të trajtohen aspektet më vitale të jetës socio-politike, historike, juridike, analitike dhe ekonomike të shtetndërtimit. Jemi të sigurt se profesionistët dhe ekspertët pjesëmarrës, me trajtimin e gjithanshëm të temës, do të vënë në dukje të arriturat e deritashme dhe pikat ku kemi ngecur dhe ku duhet të punojmë për të përmirësuar gjërat.

Po kështu, do të japim sugjerimet tona për rrugën që duhet ndjekur për një të ardhme më të prosperuar të Republikës së Kosovës.

Më lejoni gjithashtu të them se ky simpozium është iniciuar dhe është përgatitur me përkushtim dhe seriozitet nga akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar i ASHAK-ut. Prandaj, me këtë rast, i shpreh falënderimin tim Akademik Bajraktarit dhe Këshillit organizues për organizimin e këtij simpoziumi, shumë të rëndësishëm për Akademinë a edhe për Kosovën.

Andaj, Zonja dhe zotërinj,

E deklaroj të hapur simpoziumin shkencor ndërkombëtar “PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT”.

Referuesve dhe pjesëmarrësve ju uroj sukses dhe punë të mbarë.

Ju faleminderit